REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 01.09.2026 Prot.59 (pesëdhejtëenëntë)

Protokoll nr. 59

I mbajtur sot më datë 01.09.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (kuorumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (24.07.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për famije z.Ll.Saro banues në fshatin Rrëmbec Njësia Administrative Pojan, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies të zjarrit ";
6.P-V "Për një rishpërndarje në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2026 dhe palnifikim fondi për vitin 2027";
7.P-V "Për miratimin e rregullores *"Për administrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Maliq";*
8.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë: Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Eriseld Jonusllari; Klea Baçi; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Krisitna Malelli; Aramando Dautllari; Plator Çollaku; Floreta Zaçe; Yllson Ibrahimllari; Neresida Shindo; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; Andonaq Risto; Eglantina Balli; Almir Elezi; Marjeta Xhelollari; 22(njëzetëedy) këshilltarë.

Mungesa: Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Dalina Krekas; Rovena Terolli; Faslli Zholi; Enida Avdolli; Gentiana Drabo; Albina Xhejo; Ilia Xhuti; 9 (nëntë).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Përgjegjës e Shërbimit Social;znj.Johana Hoxha;

Ornildi Demollari: Mirë. Mirëdita të gjithëve. Të nderuar kolegë, i nderuar kryetar, të nderuara pjesëmarrës. Kjo është mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë tonë, të Maliqit, mbledhja për muajin gusht, sikurse edhe jemi njoftuar disa ditë përpara. Fillimisht bëjmë një verifikim të korumit dhe, me sa pashë, janë rreth 17-18 këshilltarë në sallë. Që do të thotë se korumi

realizohet dhe mund të vijojmë me mbledhjen dhe me rendin e ditës. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës. Kush është dakord?

Yllson Ibrahimllari:Përpara se të filloni me rendin e ditës, për procedurë: meqë edhe mbledhja e kryesisë ishte online dhe këto hapësirat në mbledhjet e kryesisë janë një çikë të reduktuara, gjithmonë rezultati na del 3 me 2. Ne jemi njohur nëpërmjet adresave tona të email-it me materialet e këtij rendi dite, kësaj mbledhje të zakonshme të muajit gusht. Unë mendoj që ky këshill duhet ta vazhdojë këto procedurat që kemi, themi t'i kalojmë në një seancë të mëvonshme, dhe ne duhet ta vazhdojmë mbledhjen atje ku e ndërpret mbledhjen e datës 20. Mbledhjen e thirrur jashtë radhe. Besoj që 12 ditë ju ka dalë koha. Kemi shkelur vendimin e kryesisë, kemi shkelur mendimin e dëgjesave, kemi shkelur procedurën e komisionit, dhe tashmë ne nuk kemi gjë më themelore sesa projekt-rezolutën e parlamentit për reformën territoriale, të cilën kemi kushtin për 2 muaj. Aktualisht, punë ditësh, bëhet 1 muaj që na ka ardhur projekt-vendimi. Janë kryer dëgjesat. Ne si grup këshilltarësh jemi të mendimit që këtu të debatojmë, të konsultohemi, të japim opinionet tona dhe të marrim përsipër atë që kemi si mandat. Procedurat e tjera janë procedura që na vijnë nga ligji. Ne do t'i ndjekim, sigurisht. Doni t'i quani të gjitha të miratuara? I miratojmë që tani. Por mbledhja do të fillojë në atë mënyrë siç e keni mbyllur në datë 20. Ke këshilltarë që ju kanë ndërprerë fjalën, ke njerëz prezent që nuk mund ta mbyllësh mbledhjen duke e filluar dhe pastaj të thuash "kjo mbledhje u mbyll dhe ne duam kohë të konsultohemi". Zotëria që kishit përfaqësues politik të grupit, që ishte i paqartë, të na thotë çfarë ndryshimi ka në këto 12 ditë, në këto 12 ditë, që është qartësuar ose s'është qartësuar. Kemi bërë konsultime, kemi bërë aktivitete politike, kishim këtu deputetë pjesëmarrës atë ditë, thërrasim të gjithë përfaqësuesit në Kuvendin e Shqipërisë të Qarkut të Korçës, po duam, thellohemi, diskutojmë prioritetet, ashtu siç e ka thënë dhe kryetari i bashkisë, të mirat dhe negativet që ka kjo reformë, dhe ne duhet të dalim me patjetër në një në një konkluzion për sa i përket kësaj gjëje. Ne themi si grup këshilltarësh që mbledhja të vazhdojë atje ku u ndërpre. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.Ne kemi një rend dite të paracaktuar dhe mund të vijojmë vetëm me rendin e ditës. Po, kryetar?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje të gjithëve. Në fakt, patjetër, shumë e rëndësishme edhe diskutimi që bëhet për reformën, edhe ky është një shqetësim i të gjithëve, patjetër, i organit ekzekutiv, këshillit bashkiak, i komunitetit. Unë e kam dëgjuar, e kam parë nëpërmjet rrjeteve sociale atë që ka ndodhur në mbledhjen e këshillit bashkiak. Ishte një kërkesë e grupit të opozitës për ta diskutuar, por unë mendoj që nuk është kaq, kaq emergjente në kuptimin "o sot o s'ka", pasi afati kohor është brenda 60 ditëve që projekt-akti e kërkon këtë punë. Kështu që mendoj që edhe grupi i djathtë, edhe grupi i majtë duhet të përgatisin një material i cili do të shprehë mendimin e këshillit bashkiak për t'ia çuar Kuvendit të Shqipërisë, ashtu siç unë personalisht, në pozicionin e kryetarit të bashkisë, edhe që më ngarkon dhe ligji, po përgatis një material që jam duke i dhënë dorën e fundit në kuptimin e të gjitha problematikave që unë mendoj që sjell kjo reformë. Unë e kam shprehur në komisionin parlamentar ku kam qenë si kryetar bashkie, në dëgjesën përkatëse. E kam shprehur në një dëgjesë që kam qenë në Maliq,

në pozicionin e administratorit të qytetit, se nuk ka administrator siç ka njësitë administrative ku ju keni qenë prezent. Shqetësimin tim, mendimet time, e të tjera, e të tjera. Të njëjtën gjë po e përgatis në ky material, të cilin do ja çoj Kuvendit të Shqipërisë me idetë time si e mendoj unë këtë reformë, e cila është reformë dhe administrative dhe politike. Që aty, pavarësisht se është administrative në kuptimin tonë, është politike në kuptimin e grupeve parlamentare apo të komisionit bipartizan që është marrë me reformën. Dikush thotë 46, dikush thotë 100 punë konceptimi. Të shpresojmë që aty të dëgjohet mendimi i qytetarëve, të dëgjohet mendimi i këshillave bashkiakë, të dëgjohet mendimi i kryetarëve të bashkive e në fund të bëhet më e mira për komunitetin dhe në shërbim të tyre. Unë mendoj që të dy grupet duhet të kenë një material me ide pro dhe kundra. Nuk mund të votohet për mendimin tim, por kjo është e drejta juaj, që ne jemi kundra se nuk ju ka kërkuar njeri vetë votim apo vendim. Ju ju ka kërkuar mendim si e mendoni ju këtë reformë, por që të bëhet mendimi duhet të ketë të rreshtoni, ku di unë, 20 të mira, 20 të këqija, 30 të këqija, siç ju e mendoni, edhe e djathta dhe e majta, dhe të shpresojmë që do të dilni me një raport, apo në qoftë se s'bini dakord, pastaj do ketë ndoshta një vendimmarrje për mendimet tuaja për t'i futur në material dhe për t'ia çuar Kuvendit të Shqipërisë. Unë personalisht, në pozicionin që kam, po e përgatis materialin tim dhe besoj brenda 10 ditësh, dy javësh, do ja çoj brenda afatit të përcaktuar në projekt-aktin, në projektligjin, i cili na përcakton që brenda 60 ditësh kjo duhet të mbyllet. Unë mendoj që kjo nuk duhet parë shumë politikisht sesa administrativisht në kuptim të shërbimit ndaj njerëzve dhe çfarë përfitojmë. Ne kemi një material, unë nuk e di a është njohur Këshilli Bashkiak, meqë kemi patur dhe marrëdhënie shumë të mira me bashki të forta, ku aty është përgatitur një formular i cili thotë çfarë përfiton Maliqi dhe çfarë humbet Maliqi, çfarë përfiton Korça dhe çfarë përfiton, çfarë humbet Korça në qoftë se do të ndodhë kjo reformë. Unë mendoj që dhe ky duhet të jetë pikë e materialit që ju duhet ta çoni në Kuvendin e Shqipërisë, por kjo varet prej jush, nuk ka asgjë prej meje. Si në këtë pikë po flas si dy institucione që edhe pse bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, janë të ndarë në vizion, në mendim edhe në propozime që bëjnë për Kuvendin e Shqipërisë. Por që ta mbyll, mendoj që mbledhja duhet të vazhdojë me rendin e ditës për të diskutuar ato problematika të cilat ne ju kemi sjellë, siç është ndihma ekonomike, investimet në gjimnazin e Maliqit, rregullorja për kabllot në territore, e të tjera, e të tjera, çfarë ka materiale ndihmë financiare për shtëpitë e djegura, pasi dhe ato janë disa momente të cilat ju shërbejnë qytetarëve dhe janë të domosdoshme. Pastaj këshilli ka të drejtë të vendosi, do ta bëjë mbledhjen për një javë, do ta bëjë për 10 ditë, por unë mendoj që ju të dy grupet, apo bashkërisht, ishalla bini dakord si këshill të dilni me një draft me mendim për t'ia çuar Kuvendit të Shqipërisë për këtë reformë. Shumë faleminderit.

Yllson Ibrahimllari: Faleminderit, zoti kryetar. Një sekondë se kam pasqyruar. E para, ju e thatë shumë mirë, zoti kryetar, dhe ne ju kemi ndjekur. Ju keni opsionin tuaj dhe detyrimet tuaja ligjore. Këshilli i ka bërë procedurat për këtë gjë dhe për këtë arsye dolëm me dëgjesa. Pra që mos kalojmë çik të ndërfutim dhe të bëjmë ndarje të pa sistemuara mirë. Këshilli doli dhe bëri konsultimet me komunitetin ashtu siç u zhvilluan. Janë procesverbale të atyre. Kemi qenë në mbledhjen e kryesisë dhe kemi rënë dakord me një mendim të gjithë bashkarisht. Kemi qenë te

komisioni i ligjeve dhe kemi dalë me këtë gjë. Pra këshilli e ka ezauruar procedurën nga ana formale.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Doktor, mund të të bëj një ndërhyrje.

Yllson Ibrahimllari:Më thuaj.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kryesia mund të ketë rënë dakord, po grupi i mazhorancës nuk ka rënë dakord me atë që ka vendosur kryesia.

Yllson Ibrahimllari:Përfaqësuesja e grupit të mazhorancës ishte ishte në mbledhjen e kryesisë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu::Përfaqësuesja është një përfaqësuese.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ja ku të thashë unë, ju lutem. Atëherë grupi tha: "Prit se ne do të bëjmë draftin tonë për ta çuar në këshill."

Yllson Ibrahimllari:Më fal, më fal.Të lutem. Jo, jo, ne kemi pasur edhe një draft. Po ju shpjegoj.Patjetër. Dhe unë për këtë gjë po them. Jo, më fare, fare. Unë nuk kam marrë përsipër ndonjëri i nderuar kryetar t'ju tregojë ju rregulloren e bashkisë. Jam i bindur që e dini më mirë sesa kushdo tjetër. Futem ndër këshilltarët që këtu ka valenca në këtë mes, që besoj që nuk ja hap rrugën njeriu për sa i takon rregullores së këshillit. Dhe për këtë ja ku e keni dhe kryetaren e rregullores. Tani t'i lëmë këto dhe të dalim këtu. Doni të dalim me një draft? Pse erdhën konsultimet? Pse nuk e përgatiti grup X, grup apo grupi tjetër projekt-draftin dhe ta sillte në datë 20? Ishin mbyllur konsultimet. Atëherë është në aspektin njerëzor. Mua më ngele të të uroj, të të uroj nipi e me jetë të gjatë. Problemet e tjera lëre këshillin të bëjë punën e vetë. Ne të lutem si ekzekutiv jepe mendimin. Ne nuk ndërhyjmë. Kemi shumë, kemi shumë dëshirë dhe besoj që për pak ditë dhe për pak kohë ju do ngriheni në ato përmasa që kini edhe si pasojë e përvojës tuaj personale në ekzekutiv. Por unë mendoj që ky këshill nëse nuk merret me atë që ka më themelore është e kotë të vazhdojmë me procedurat e tjera. Ne si grup tërhiqemi nga kjo mbledhje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:JNuk nuk kam ndërhyrë ndonjëherë në mbledhjen e këshillit. Nuk nuk dua të ndërhyj ndonjëherë dhe po ju them që ideja është që ju duhet të bëni një draft për ta futur, por ju s'duhet të lini ndihmën ekonomike pa miratuar. Ju s'duhet të lini trenin e zjarrit pa miratuar që ndihmoni. Ju s'duhet të lini investimet në arsim pa miratuar, të cilat ministria i ka sjellë dhe kërkon okejnë tuaj dhe mua kjo më duket nonsense. Pa mbledhjen e radhës kur do ta bëni bëheni.

Lulëzim Hoxhaj: Jo, unë jam dakort me këtë të doktorit dhe unë edhe unë do ngrihem do ik. Po me thënë të drejtën nuk mund të rri pa i thënë dy fjalë. E para njëherë një ndjesë kryetarit duhet të kërkosh një ndjesë publike për mënyrën se si e ke mbyllur atë mbledhjen për radhën e parë. Fjalia që përdore atë ditë ishte fjalia më e pagjetur që mund të jetë në fjalorin shqip. Ishte shumë

ofenduese për të gjithë ne që kishim erdhur këtu. U tha që kemi erdhur për këtë punë dhe me një fjali e ke mbyllur atë. Nuk e di ku u gjet ajo fjali e para. E dyta duhet të dëgjoheshin, të paktën të dëgjoheshin. Dakord. Më po dëgjoheshin edhe nga krahu i majtë edhe nga krahu i djathtë. Se atë ditë erdhëm për të diskutuar dhe në fund fare të dilje me mendimin që akoma jemi të paqartë për këtë e të merrje ky vendim se votat ishin. Do ishte shumë shumë më më e rrugës. Unë nuk kam ndërmend sot të sjell argumentat dhe të them argumentat pse duhet të qëndrojë ose mos qëndrojë bashkia e Maliqit. Unë e kam unë i kam ndjekur me me edhe me kërshëri po edhe me me një lloj kështu ë ë jo tifozlë po e kam i kam ndjekur edhe prononcimet tuaja edhe prononcimet e kryetarit. Në prononcimet që janë bërë me fjalë aty shihet qartë mendimi juaj, mendimi i gëzimit, mendimi i tënd edhe mendimi i të gjithëve. Është çudi o burri pse duhet atë që mendoni të mos e thoni. Përse nuk ka nuk ka nevojë, nuk ka njeri ta besojë këtë që tani jemi kemi një paqartësi edhe thashë unë jam shumë dakort më. Po kur të kur të merret ky vendim të thuhet që këto janë anë pozitive, këto janë anë negative e të tjera e të tjera, por duhet duhet njerëzit të shprehen. Njerëzit shprehen dhe në fund vendosin. Domethënë kjo ishte që duhet të duhet duhet ta thoja me thënë të drejtë me thënë të drejtën atë ditë kemi ngelur shumë shumë të ofenduar edhe një gjë sepse u trajtua nga nga kryetari nga gëzimi që janë shumë të nevojshme këto ndihma ekonomike presim çfarë do të investohet për shkolla e të tjera e të tjera e të tjera që duhet të kalojnë patjetër në këshillin bashkiak. Më besoni sot edhe përtej po sot këto 20 minuta që kemi erdhur përpara mbledhjes këtu nuk ka ngelur njeri edhe pjesë e administratës ta dini edhe njerëzit e tjerë me fjalë që janë rreth e rrotull mos do bëhet me bashki. Ore ky është ky është kjo është çështja e ditës sot. Sot çështja e ditës është kjo. Është naivitet. Mos e mos e mos e mos e kuptojmë këtë. Më kanë marrë nga më morën nga Greqia. Besoni grekë që nuk e di as shqipen as ku bie Maliqi as ku e di që unë kam një lidhje me Maliqin. Edhe Maliq më tha mua tha cili ishte ai kryetari ajo anëtari i këshillit tha me atë shkopin tha ka bërë lajmin e ditës mo ka ka shëtitur gjithë botën. Të mos e marrim qesharake këtë. Mos e marrim qesharake dhe unë nuk nuk e mendoj dhe është në nderin e të gjithëve neve. Nuk e mendoj që të themi tani që tani duhet të vazhdojmë të mendohemi akoma. Ka për të menduar këtu. Unë mendoj që nuk ka për të menduar fare në fakt. Është e qartë për të gjithë që nga kryetari i bashkisë, që nga ju, që nga të gjithë këshilltarët. Të ngrihen të gjithë këshilltarët këtu edhe le të thonë që po kemi nevojë të mendohemi. Edhe Petriti Petriti kur filloi dhe tha po duhet të mendohemi për këtë punë e këtej pa andej atë ditë u skuqi te sepse nuk mendon kështu. Të gjithë ja të gjithë që jemi këtu le të ngrihen le ta le ta lë ashtu. Kështu që mbarove unë mbarova.

Ornildi Demollari: Idlir e ka fjalën Idliri.

Ildlir Limllari: Nildi unë jam kundra. Nuk jam dakort. Jam me bashkimin.Largohen nga mbledhja z.Yllson Ibrahimllari, z.Server Xhuti, z.Almir Elezi, z.Lulëzim Hoxhaj, znj.Eglantina Balli, znj.Neresida Shindo.

Ornildi Demollari: Mirë. Ju lutem bëjmë një 10 minutëshe pushim.

Ornildi Demollari: Mirë, rifillojmë edhe një herë mbledhjen e radhës të këshillit të bashkisë, pasi ndërprerje nga pjesa e parë e mbledhjes.

Këshilltarë të pranishëm në sallë: Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Eriseld Jonusllari; Klea Baçi; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Selami Muço; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Krisitna Malelli; Aramando Dautllari; Plator Çollaku; Floreta Zaçe; Marianthi Avrami; Rovena Terolli; Andonaq Risto; 17(shtatëmebëdhjetë) këshilltarë.

Ornildi Demollari: Dua të vazhdoj aty ku e ndërpremë, dhe që ka të bëjë me reformën administrative territoriale, një diskutim që e nisëm në pjesën e parë të mbledhjes. Dua të theksoj edhe një herë që të gjitha grupet e këshillit bashkiak duhet të përgatitin draft-propozimet e tyre dhe t'i paraqesin në këshill. Këshilli, në një mbledhje të posaçme brenda 60 ditëve, siç është edhe afati që ka përcaktuar Kuvendi, do t'i diskutojë këto mendime, do t'i unifikojë dhe, në një mendim të përbashkët, do t'ia përcjellim përgjigjen Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Kaq për këtë pikë. Tani jemi tek rendi i ditës. Në këtë pjesë të dytë, jemi 16 këshilltarë në sallë, që do të thotë se kuorumi realizohet dhe mund të vijojmë me mbledhjen dhe me pikat e ditës. Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës. Kush është dakord me rendin e ditës? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Me 16 vota pro, miratohet. Ju ftoj të miratojmë vendimet e mbledhjes së kaluar: janë gjithsej 3 me karakter normativ dhe 6 me karakter kolektiv. Kush është dakord me jo, këto nuk votohen, më falni, thjesht janë për njohje. Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar.
Kush është dakord me protokollin? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Me 16 vota pro, miratohet protokolli i mbledhjes. Kalojmë tek pika 4 e rendit të ditës, por ndërkohë, më falni, t'ju rikujtoj edhe një herë konfliktin e interesit. Në qoftë se dikush nga këshilltarët ka konflikt interesi me ndonjë nga pikat, është mirë të mos përfshihet as në votim, as në diskutim. Kalojmë tek pika 4 e rendit të ditës: vendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2026. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me 16 vota pro, miratohet. Kalojmë tek pika 5 e rendit të ditës: projektvendim për dhënien e ndihmës financiare për familjen e zotit Ll. Saro, banues në fshatin Rrëmbecin, si administrative po janë, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit. Ka ndonjë pyetje për këtë? Ka nevojë për shpjegim?
Ornildi Demollari:E kalojmë në votim? Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Me 16 vota pro, miratohet. Kalojmë tek pika 6 e rendit të ditës, që është projektvendim për një rishpërndarje në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2026 dhe planifikim fondi për vitin 2027. Ka ndonjë... Komisioni, të lutem.

Petrtit Kupe: Komisioni është dakord për këtë projektvendim, për dy investime të rëndësishme që mendohet të kryhen gjatë këtij viti dhe në vitin e vazhdim: për rikonstruksionin e shkollës së mesme "Maliq", si dhe për rrugën e fshatit Kolanec, me bashkëfinancim me këshillin e qarkut. Jemi ok.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim atëherë.
Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me 16 vota pro, miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika 7 e rendit të ditës: projektvendim për miratimin e rregullores për administrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë Maliq. Ka ndonjë pyetje për këtë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Një shpjegim të shkurtër: bëhet fjalë për disiplinimin e kabllove në territor. Me këtë rregullore, tashmë nuk lejohet më vendosja e kabllove ajrore dhe të gjitha bizneset që merren me këtë lloj shërbimi janë njoftuar që ata duhet të fillojnë të bëjnë sistemimin e largimit të kabllove ekzistuese dhe futjen e tyre pjesë-pjesë në rrjet nëntokësor, në investime që bashkia i bën vetë apo në investime që ata do të realizojnë me projekte të miratuara nga zyrat e urbanistikës. Puna ka filluar, është një proces i vështirë. Ne kemi bërë një plan veprimi dhe një kalendar ndërmjet, i cili do të zgjasë në kohë, të themi, por është një farë disiplinimi i cili del i domosdoshëm për heqjen e merimangave nga territori.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Ka ndonjë pyetje këtu? Ndonjë gjë të paqartë? Mbledhjes i bashkohet dhe këshilltarja znj.Rovena Terolli, shkon në 17 (shtatëmbëdhjetë) numri i këshilltrave në sallë.E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 17 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. Me 17 vota pro, miratohet. Faleminderit. Dhe pika e fundit është: diskutime të tjera. Kemi ndonjë gjë te kjo pjesë? Një kërkesë tjetër ta marrim parasysh ë drejtuar këshillit bashkiak Maliq për dijeni ekzekutivit dhe kryetarit të bashkisë zotit Gëzim Topçiu unë i nënshkruari Haxhi Shahin Elmazi i datëlindjes 28.01.1961 lindur në fshatin Memël bashkia Maliq kërkoj si gjithë qytetarët e tjerë kam nevojë për ujë të pijshëm në pronën time dhe banesën time të cilën paguaj edhe detyrimet si gjithë qytetarët e tjerë problemi qëndron sepse është bërë riparimi i ujësjellësit dhe mua më kanë anashkaluar dhe më kanë lënë pa ujë me dashje apo arsye të tjera nuk e di por unë jam pa ujë kërkoj të më krijohet mundësi të marr ujë kundrejt çdo pagese sipas rregullave ngelem në zgjidhjen e këtij problemi nga ana juaj me respekt Haxhi Elmazi është një është një banor i zonës të Libonik të Zbogjerisë i cili kërkon ujë. Mirë, faleminderit. Kjo ishte mbledhja për sot. Ditë të mbarë në vazhdim.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT **KRYETARI I KËSHILLIT**

Gertjan GJIRITI **Ornildi DEMOLLARI**